

Nis peticioni për
shkarkimin e kryetarëve
edhe në Zvečan dhe
Zubin Potok I FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FSK-JA NISËT PËR NË BRITANI, DO TA BËJË PËRGGATITJEN E USHTARAKËVE UKRAINAS. I FAQE 4-5

Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) është nisur për në Mbretërinë e Bashkuar për operacionin "Interflex", i cili realizohet në mbështetje dhe përgatitje të personelit ushtarak të Ukrainës. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se me këtë rast po shënohet një sukses i radhës i FSK-së dhe një arritje tjetër e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Republikës së Kosovës me pjesëmarrjen e ekipeve të FSK-së në kuadër të operacionit "Interflex". Operacioni "Interflex" zhvillohet në Mbretërinë e Bashkuar dhe ka për qëllim trajnimin e trupave të ushtrisë së Ukrainës.



AKTUALE



GJERMANIA THJESHTËSON MASAT
PËR DËBIM TË TË HUAJVE PA LEJE
QËNDRIMI F. 2

REAGIM I KMDLNJ-SË: TRAJTIM DHE
PËRFUNDIM I PADINJITETSHËM I
KRYETARËVE TË KOMUNAVE NË VERI
TË KOSOVËS F. 6

DNV KËRKON TRAJTIM TË SHPEJTË
TË KUSHTETUTSHMËRISË SË LIGJIT
PËR ZGJEDHJE LIDHUR ME KUOTËN
GJINORE F. 7


EKONOMI



AKB-ja: MBI 1 600 BIZNESE U
MBYLLEN NË VITIN 2023 NË KOSOVË F. 8

HOTI, QEVERISË: NDIHMA E
NJËHERSHME NUK ËSHTË ZGJIDHJE
PËR INFLACIONIN F. 8

SPORT



MENTORËT E UEFA-S TË KËNAQUR
ME ZHVILLIMIN DHE MASIVIZIMIN
E FUTBOLLIT NË KOSOVË F. 10



KONGRESMENI TORRES: SHBA-ja
NUK KA ALEAT MË TË MADH
SE KOSOVËN NË BALLKAN F. 5

POLICIA PRANON
DONACION VETURA DHE
PAJISJE TEKNOLOGJIKE
NGA AMBASADA GJERMANE F. 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania thjeshtëson masat për dëbim të të huajve pa leje qëndrimi

BERLIN, 19 JANAR - Pas një periudhe tensionesh brenda koalicionit qeverisës gjerman, Dhoma e Ulët e Parlamentit, apo Bundestagu, miratoi një projektligj që përfshin një sërë masash, sikurse zgjatja e masës së paraburgimit për ta parandaluar dështimin e dëbimeve të shtetasve të huaj. Këto masa do ta lehtësojnë procesin e dëbimit të të huajve pa leje qëndrimi. Një ndër masat e miratuara edhe zgjatja e periudhës maksimale ligjore të paraburgimit për personat që janë në pritje të dëbimit nga 10 ditë në 28 ditë. Për më tepër, përfaqësuesit e autoriteteve tani do të lejohen të

hyjnë në dhomat e përbashkëta të personave që janë në proces dëbimi, e jo vetëm në dhomën e personit që do të dëbohet nga shteti. Në të kaluarën dëbimet raportohet se kishin dështuar për shkak se personat që ishin në proces dëbimi nuk mund të gjendeshin nga autoritetet. Në vitin 2012 filloi një rritje e madhe e numrit të shtetasve nga Ballkani Perëndimor që e tejkalonin kohëzgjatjen e lejuar të qëndrimit të tyre në BE. Numri më i madh i tyre vinin nga Shqipëria dhe Serbia. Projektligji ishte hequr nga rendi i ditës përmes një njoftimi të

minutës së fundit gjatë seancës së fundit para Krishtlindjes. Tërheqja e kësaj pike nga rendi i ditës u bë për shkak se, një prej partnerëve të koalicionit qeverisës gjerman, Të Gjellbrit, kërkuan përmirësimin e legjislacionit. Për shkak të insistimit të kësaj partie, tani është garantuar që personat që janë në procedurë dëbimi do t'u sigurohet një avokat. Ligji parashikon gjithashtu masa më të ashpra kundër trafikantëve me njerëz. Për shkak të protestave të organizatave për të drejtat e njeriut, një paragrafi futur më vonë në legjislacion, sqaron se kjo nuk i prek njerëzit që shpëtojnë refugjatë në det.



Kongresi voton për ta shmangur mbylljen e qeverisë amerikane



UASHINGTON, 19 JANAR - Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara ka miratuar një projektligj për ta financuar qeverinë federale deri në fillim të marsit, duke shmangur mbylljen e pjesshme të qeverisë. Ky projektligj i është dërguar presidentit Joe Biden për miratim final. Projektligji kaloi me 314 vota për dhe 108 kundër, me 106 republikanë dhe dy demokratë që votuan kundër. Para se projektligji t'i dërgohej Dhomës më 18 janar, Senati e kaloi atë me 77 vota për dhe 18 kundër, para se të përfundonte afati të premten. "Kemi lajme të mira për Amerikën. Nuk do të kemi mbyllje

të premten", tha lideri i shumicës në Senat, demokrati Chuck Schumer. Por, me këtë qëndrim nuk u pajtuan disa republikanë të ekstremit të djathtë në Dhomën e Përfaqësuesve. Si Senati, ashtu edhe Dhoma, përshpejtuan seancat për votim për shkak të parashikimeve se do të ketë një stuhi dimërore të premten që do të mund ta pengonte mbajtjen e seancave për votim të projektligjit për financimin e përkohshëm të qeverisë federale. Në Senat demokratët janë shumicë dhe Dhoma kontrollohet nga republikanët. Ligjvënësit amerikanë deri më tani nuk kanë arritur të pajtohen për financimin e

vitit të ri fiskal që ka nisur më 1 tetor. Schumer dhe homologu i tij republikan në Dhomë, Mike Johnson, më herët gjatë këtij muaji u pajtuan për një nivel diskrecional të shpenzimeve në vlerë prej 1.57 trilionë dollarësh për vitin fiskal që përfundon më 30 shtator. Por, tani Kongresi është ndarë dhe dy partitë nuk po pajtohen për këtë shifër, me demokratët që kanë thënë se shifra me të cilën janë pajtuar është 1.66 trilion dollarë. Me miratimin e projektligjit për financim të përkohshëm, që tani është drejt miratimit, fokusi tani do të jetë në nevojën për të kaluar edhe 12 projektligje për buxhetin e plotë të vitit.

Netanyahu thotë se nuk pajtohet me ShBA-në për krijimin e një shteti palestinez

JERUSALEM, 19 JANAR - Kryeministri Benjamin Netanyahu ka refuzuar thirrjet e Shteteve të Bashkuara që Izraeli ta ulë intensitetin e ofensivës së tij ushtarake në Rripin e Gazës ose të ndërmarë hapa drejt krijimit të një shteti palestinez pasi të mbarojë lufta. Ky refuzim i tij shkaktoi menjëherë kritika nga Shtëpia e Bardhë. Tensionet për këto çështje reflektuan një përçarje të madhe mes dy aleatëve lidhur me madhësinë e luftës së Izraelit dhe planet e tij për të ardhmen e territorit të rrethuar. "Ne sigurisht e shohim këtë ndryshe", tha zëdhënësi i sigurisë kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, John Kirby. Deklarata e Netanyahu më 18 janar erdhi një ditë pasi sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se Izraeli nuk mund të ketë asnjëherë "siguri të mirëfilltë" pa një rrugë drejt pavarësisë palestineze. Më herët gjatë kësaj jave, Shtëpia e Bardhë ka thënë se është "koha e duhur" që Izraeli ta ulë intensitetin e ofensivës së tij shkatërruese në Gazë. Gjatë një konference për medie,

Netanyahu shprehu një qëndrim të ndryshëm nga Uashingtoni. Ai vazhdimisht deklaroi se Izraeli nuk do ta ndalë ofensivën derisa t'i përmbyshë qëllimet e tij për ta shkatërruar Hamasin - grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - dhe të kthejë në shtëpi pengjet që po mbahen nga grupi radikal palestinez. Ai hodhi poshtë pretendimet në mitje nga kritikët izraelitë se këto qëllime nuk janë të arritshme, duke u zotuar se do ta shtyjë përpara ofensivën për muajt të tërë. "Ne nuk do të pajtohemi me asgjë tjetër përpos fitores absolute", tha Netanyahu. Izraeli nisi ofensivën pas sulmit të paprecedent të Hamasit në jug të Izraelit më 7 tetor, kur luftëtarët e grupit vranë 1 200 persona dhe morën peng afër 250 të tjerë. Afër 130 pengje Izraeli beson se ende janë nën robërimin e Hamasit. Lufta ka rritur tensionet në mbarë rajonin, duke kërcënuar nxitjen e konflikteve të tjera.



Sulmi i Izraelit, një prej fushatave ushtarake më vdekjeprurëse dhe më shkatërruese në historinë moderne, ka lënë të vrarë pothuajse 25 000 palestinezë, sipas autoriteteve shëndetësore në Gazë. Ofensiva izraelite, po ashtu, ka shkakuar shkatërrim të madh dhe mbi 80 për qind e popullsisë së territorit me 2.3 milionë banorë janë larguar nga shtëpiat e tyre. Kostoja e madhe e luftës ka çuar në shtimin e thirrjeve të komunitetit

ndërkombëtar që Izraeli ta ndalë ofensivën. Aleatja kryesore e Izraelit, ShBA-ja, ka nisur të shprehë mospajtime dhe i ka bërë thirrje Netanyahu të tregojë vizionin e tij për Gazën e pasluftës. ShBA-ja ka thënë se Autoriteti Palestinez, që njihet ndërkombëtarisht dhe që qeverisë në zonat gjysmëautonome në Bregun e pushtuar Perëndimor nga Izraeli, duhet të "rigjallërohet" dhe të kthehet në Gazë. Hamasi kishte rrëzuar nga pushteti Autoritetin Palestinez në Gazë më 2007. ShBA-ja, po ashtu, ka bërë thirrje për ndërmarjen e hapave drejt krijimit të një shteti palestinez. Palestinezët kërkojnë që Gaza, Bregu Perëndimor dhe Jerusalemi Lindor të jenë pjesë e shtetit të tyre të ardhshëm. Këto zona ishin pushtuar nga Izraeli më 1967. Gjatë forumit ekonomik në Davos, të mërkurën Blinken tha se zgjidhja me dy shtete është mënyra më e mirë për ta mbrojtur Izraelin, për t'i bashkuar vendet e moderuara arabe dhe për ta izoluar armikun e përbetuar të

Izraelit, Iranin. Pa "një rrugë drejt një shteti palestinez", tha ai, Izraeli nuk do të ketë "siguri të mirëfilltë". Netanyahu, që udhëheq një qeveri të ekstremit të djathtë dhe që një kohë të gjatë kundërshton shtetësinë palestineze, vazhdimisht ka kundërshtuar zgjidhjen me dy shtete. Ai tha se një shtet palestinez do të bëhej vend për nisjen e sulmeve ndaj Izraelit. Ai tha se Izraeli "duhet ta ketë kontrollin e sigurisë mbi gjithë territorin në përfundim të lumit Jordan", duke shtuar se "kjo bindesh me idenë e sovranitetit. Çfarë mund të bëjmë ne?". "Këtë të vërtetë ua them miqve tanë amerikanë dhe kam frenuar përpjekjen për të na detyruar në një realitet që do ta rrezikonte shtetin e Izraelit", tha ai. Deklaratat e tij nxitën reagimin e menjëhershëm nga Shtëpia e Bardhë. Kirby tha se presidenti amerikan, Joe Biden, nuk "do të ndalojë së punuari" drejt zgjidhjes me dy shtete.

Kongresmeni Torres: ShBA-ja nuk ka aleat më të madh se Kosovën në Ballkan



PRISHTINË, 19 JANAR - Kongresmeni Richie Torres, në një intervistë për "Radio Kosovën", duke folur rreth kërkesës së Kosovës për blerjen e raketave 'Javelin' dhe miratimit nga Departamenti Amerikan i Shtetit, ka thënë se ShBA-ja nuk ka aleat më të madh se Kosovën dhe se për këtë ka mbështetje edhe të kongresmenëve.

Z. Torres, në rajonin e Ballkanit shtetet kanë filluar të blejnë armatim, sidomos pas luftës në Ukrainë. Këto ditë Departamenti Amerikan i Shtetit ka miratuar kërkesën e Kosovës për shitjen e një numri të raketave Javelin. Si e shihni këtë nga perspektiva e sigurisë?

Ritchie Torres: Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë aleat më të madh se Kosovën dhe kjo është në interes të ShBA-së që t'i mbështesë aleatët e saj, siç është shitja e raketave 'Javelin'. Ju e keni mbështetjen e kongresistëve amerikanë edhe këtu në Uashington dhe për këtë ne përpiqemi t'ju ndihmojmë gjithashtu.

Lufta në Ukrainë, por edhe lufta në Gaza, mes Hamasit dhe Izraelit, ka nxjerrë në pah një trend të ri të ndikimit të shteteve në botë. Kemi ShBA-në dhe BE-në, pra vendet perëndimore në një

anë dhe, në anën tjetër, Rusinë dhe Kinën. Si e vlerësoni tendencën e Rusisë, nëpërmjet Serbisë, për ta ushtruar ndikimin e saj në rajonin e Ballkanit?

Ritchie Torres: Presidenti Joe Biden ka folur për demokracinë dhe tensionet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë pjesë e kësaj politike. Kosova është një demokraci, një storie demokratike në Ballkanin Perëndimor, ndërsa Serbia është një vend autokrat, përdërsa Kosova është një aleate e ShBA-së. Kosova ishte e para që pranoi refugjatë, derisa Serbia është satelit i Rusisë dhe nuk ka vendosur sanksione ndaj saj, por në të kundërtën ka importuar armë nga ajo. Presidenti rus Vladimir Putin është figura më e çmuar në Serbi.

Z. Torres, ShBA-ja po hyn në fazë të zgjedhjeve të cilat do të mbahen gjatë këtij viti. A besoni që, pavarësisht se kush do të fitojë, republikanët apo demokratët, politika amerikane mund të ndërrojë në raport me Kosovën?

Ritchie Torres: Jam i bindur që presidenti Joe Biden do ta udhëheqë ShBA-në dhe do të jetë më miqësor për Kosovën. Administrata e ish-presidentit Donald Trump ka bërë shumë gabime dhe ka anësi për Serbinë,

e jo për Kosovën. Besoj se presidenca e Joe Bidenit do të ishte më e interesuar për Kosovën.

Në Kosovë, në shtator të vitit 2023, kemi pasur një sulm terrorist në rajonin verior të Kosovës, i cili është i banuar me shumicë serbe. Pas këtij sulmi, ShBA-ja ka thënë me zë të lartë se Kosova ka të drejtë ta mbrojë territorin e saj; BE-ja duket më e rezervuar në këtë drejtim. Pse ka tolerancë nga BE-ja në raport me Serbinë, e cila tregon shumë hapur tendencat e saj për destabilizimin e rajonit?

Ritchie Torres: Bashkimi Evropian ka qenë më i ashpër ndaj Kosovës sesa ndaj Serbisë. Derisa Kosova është e radhitur në krah të BE-së, Serbia është më afër Rusisë. Sjellja e BE-së është një storie më vete dhe nuk mund ta shpjegoj. Por Kosova duhet të trajtohet me më shumë respekt, sepse është një aleate më e mirë. Serbia ka treguar se përzihet në punë të brendshme të Kosovës duke bashkëpunuar me njerëz që kanë për qëllim destabilizimin e Kosovës.

A ka mbështetje më të madhe të ShBA-së për Serbinë, veçanërisht për ta tërhequr më tej nga ndikimi i politikës ruse?

Ritchie Torres: Mund të ketë disa

politikëbërës që thonë se Serbia, por unë jam skeptik, mund të largohet nga ndikimi rus, por dhe kjo nuk mund të jetë reale. Ne jemi në anën e Kosovës dhe ka të drejtë të njihet duke ia dhanë mundësinë të jetë pjesë e institucioneve siç është Këshilli i Evropës, por edhe anëtarësimi në BE. Kosova duhet të jetë pjesë e demokracive evropiane.

Si i shihni sanksionet e Bashkimit Evropian kundrejt Kosovës kur ato nuk i janë vendosur Serbisë si i vetmi vend në BE që nuk ka vendosur sanksione ndaj Rusisë?

Ritchie Torres: Ky është një mister edhe për mua, kur në këtë formë BE-ja dënon Kosovën dhe jo Serbinë. Kjo më duket fundamentalisht e padrejtë. Serbia është anëtare e Partneritetit për Paqe, kurse Kosova është e përjashtuar. Kosova është e radhitur krah BE-së, kurse Serbia me Rusinë. Qartazi mendoj se është zhgënjim që BE-ja është treguar e njëanshme ndaj Kosovës.

A duhet të marrë ShBA-ja një rol më të madh udhëheqës në bisedimet Kosovë - Serbi?

Ritchie Torres: Unë vërtet besoj që ShBA-ja është udhëheqëse e botës së lirë dhe ka një rol aktiv në dialogun ndërmjet Serbisë dhe

Kosovës. Dialogu është esencial dhe duhet të vazhdojë të udhëhiqet nga ShBA-ja.

A duhet Kosova të anëtarësohet në NATO, sepse të gjitha vendet e rajonit, përjashtoj Bosnjë-Hercegovinën, janë anëtare të NATO-s?

Ritchie Torres: Së pari Kosova duhet të njihet si shtet dhe të përfshihet në institucionet evropiane, siç është anëtarësimi në BE, pastaj të anëtarësohet edhe në OKB dhe Interpol, por edhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Kosova është një vend sovran dhe duhet të trajtohet si e tillë.

Bronk (lagje në Nju-Jork) ka popullsinë më të madhe shqiptare në Shtetet e Bashkuara. Duke qenë se jeni përfaqësues i Bronksit në Kongres, cilat janë marrëdhëniet tuaja me komunitetin shqiptar atje?

Ritchie Torres: Jam krenar të them që kam bashkëpunim të mirë me komunitetin shqiptar nga Kosova dhe unë jam i afërt me udhëheqësit e komunitetit shqiptar. Kur u bëra kongresist u bë e qartë që shqiptarët do të ndihmonin. Ata kanë bartur trashëgiminë e të parëve të tyre dhe shpresoj që kjo të vazhdojë edhe më tutje.



FSK-ja niset për në Britani, do ta bëjë përgatitjen e ushtarakëve ukrainas

Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) është nisur për në Mbretërinë e Bashkuar për operacionin “Interflex”, i cili realizohet në mbështetje dhe përgatitje të personelit ushtarak të Ukrainës. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se me këtë rast po shënohet një sukses i radhës i FSK-së dhe një arritje tjetër e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Republikës së Kosovës me pjesëmarrjen e ekipeve të FSK-së në kuadër të operacionit “Interflex”. Operacioni “Interflex” zhvillohet në Mbretërinë e Bashkuar dhe ka për qëllim trajnimin e trupave të ushtrisë së Ukrainës

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, me këtë rast tha se po shënohet një sukses i radhës i FSK-së dhe një arritje tjetër e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Republikës së Kosovës. Ai ka theksuar se pjesëmarrja e ekipeve të FSK-së, në kuadër të operacionit “Interflex”, për trajnimin dhe përgatitjen e ushtarakëve ukrainas, tregon për besimin që Mbretëria e Bashkuar si drejtuese e këtij aktiviteti shumëkombësh ka në përkushtimin, integritetin dhe përgatitjen profesionale të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së

Kosovës. “Mbretëria e Bashkuar ishte në krah të popullit dhe Republikës sonë në të gjitha etapat e shtetndërtimit dhe vazhdon të mbetet partnerja jonë e pazëvendësueshme, me të cilën kemi ndërtuar raporte përtej miqësore, raporte këto që kanë bazë vlerat e përbashkëta dhe besimin e ndërsjellë”, u shpreh ministri Maqedonci, duke shtuar se Republika e Kosovës është plotësisht e vendosur në rrugën e saj drejt integritetit në strukturat euroatlantike dhe e përkushtuar ta japë kontributin e saj për paqe dhe

stabilitet jo vetëm në region, por dhe më gjerë.

Ministri Maqedonci i uroi kontingjentit të FSK-së punë të mbarë dhe suksese në detyrën e tyre fisnike dhe përmbyllje të suksesshme të misionit.

Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, u shpreh i lumtur që përmes bashkëpunimit të shkëlqyeshëm në mes të FSK-së dhe Ushtrisë Britanike, është arritur të dërgohet ky kontingjent i ushtarakëve të FSK-së si instruktorë në operacionin “Interflex”. “Si popull kemi kaluar shumë sfida dhe jemi ballafaquar vazhdimisht me agresorë. Ne e kuptojmë më së miri rëndësinë e këtij misioni. Andaj e kemi obligim ta ndihmojmë popullin e Ukrainës në përpjekjet e tyre për liri ashtu siç na kanë ndihmuar dhe kanë qëndruar pranë nesh aleatët tanë në kohët më të vështira”, u shpreh gjeneral Jashari, duke shtuar se ky mision i rëndësishëm dhe misioni të ngjashme ku po angazhohet FSK-ja, po tregojnë qartë se Kosova dita-ditës po shndërrohet nga konsumuese e sigurisë në kontribuuese të paqes në botë dhe vlerave të mirëfillta demokratike. Të pranishmëve në ceremoni iu

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 JANAR - Në Ministrinë e Mbrojtjes është mbajtur një ditë më parë ceremonia e nisjes së Kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Operacionin “Interflex”, që realizohet në koordinim me Mbretërinë e Bashkuar, në mbështetje dhe përgatitje të personelit ushtarak të Ukrainës.

Në këtë ceremoni morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari,

zëvendësministri i Ministrisë së Mbrojtjes, Shemsi Sylja, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, zëvendësambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, Paul O'Connor, drejtori i NALT-it, gjeneralbrigade Ralf Hammerstein, zëvendëssekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Gafurr Dugolli, gjeneralbrigade Ilir Qeriqi, gjeneralbrigade Hysen Dreshaj, si dhe zyrtarë të lartë dhe oficerë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe Mbretërisë së Bashkuar.



Haradinaj: Ka më shumë se tre vjet që ky pushtet është në luftë me komunat që nuk janë të partisë së tij

PRISHTINË, 19 JANAR - Në pritjen tradicionale të AAK-së për fillimit, kryetari i saj Ramush Haradinaj ka thënë se shteti sot e ka harruar njeriun e Kosovës. Sipas tij, e ka lënë në mëshirën e vet. “Ai sot përballet me fukarallëkun, me papunësinë, me emigrimin. Kosova sot është vendi më i varfër në Evropë dhe qeveria në vend se të merret me njeriun e vet, ka vendosur ta pasurojë veten. Me pagat më të ulëta, me çmime jashtë çdo kontrolli, me pensione qesharake, me çmime të papërbalueshme të energjisë e të bukës. Qeveria paratë e taksapaguesve i ruan në bunkerin e vet financiar e nuk i investon në mirëqenien e popullit”, ka thënë ai. Haradinaj ka thënë se njeriu i Kosovës sot është i papërfqësuar, i kundërshtuar dhe i luftuar. “Pushteti politik i ka shpallur luftë edhe njeriut edhe strukturave të shtetit. Ka më shumë se tre vjet që ky pushtet është në luftë me komunat që nuk janë të partisë së tij, në luftë me gjyqësorin, me prokurorinë, me policinë, me mësimdhënësit, me mjekët e

infirmierët, me veteranët, me sindikatat, me bizneset, me mediet e gazetarët. Ky pushtet është në luftë me secilin që e ka mendjen e tij e nuk mendon si ai. Është në luftë me njeriun e Kosovës”, është shprehur Haradinaj, duke shtuar se shoqëria në Kosovë sot është përballë një pushtimi modern të pushtetit, që po bëhet përmes shantazhit, mashtrimit e shpëlarjes së trurit. “Na kanë bërë më të varfër, sepse po na vjedhin edhe në xhep, por edhe të ardhmen. Jemi më pak, sepse po ikin njerëzit nga depresioni e fukarallëku. Edhe miqtë po na largohen, sepse kemi filluar t’i zhgënjëjmë edhe ata. Jemi vendi i vetëm në Evropë, që jemi nën sanksione të Bashkësisë Ndërkombëtare”, është shprehur Haradinaj. Lideri i AAK-së ka pyetur: “Por cili është shpëtimi!? Hapi i parë i këtij shpëtimi është që populli t’i vë sanksione këtij kryeministri e kësaj qeverie; Që të mos ketë më mashtrime me shifra fiktive, por rritje ekonomike të jetë reale; Që ndihmat sociale të shndërrohen



në paga e pensione të dinjitetshme; Që Kosova të mos jetë vend me shëndetësi të sëmurë e me arsim që nuk garanton dije; Që të mos jetë vend ku poshtërohen kategoritë e lirisë, po ku trajtohen me dinjitet; Ku komunat nuk do të jenë të partive por të qytetarëve; Ku pushtetet të

jenë të ndara e pa diktatin e Partisë-Shtet. Më në fund ku Kosova të mos jetë vend ku krejt duanë me dalë prej tij, por vend i perspektivës, i mundësive e i lirie. Ku me partnerët ndërkombëtarë, do të punohet ngushtë e pa hile, e ku nuk do të ketë forcë që mund ta devijojë Kosovën në kursin e saj

euro-atlantik e në marrëdhënie të posaçme me Amerikën. Kosova në NATO, në BE dhe OKB, nuk është vetëm orientim politik, por edhe popullor i këtij vendi dhe këtë nuk do të mund ta ndërrojë askush. Këto synime nuk mbërrihen lehtë, por zgjidhje tjetër nuk ka”, ka theksuar Haradinaj.

Nis peticioni për shkarkimin e kryetarëve edhe në Zveçan dhe Zubin Potok

PRISHTINË, 19 JANAR - Në Zveçan dhe Zubin Potok ka nisur mbledhja e nënshkrimeve për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në këto dy komuna në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe. Ngjashëm, me organizimin dhe nën udhëheqjen e Listës Serbe, më 17 janar nisi mbledhja e nënshkrimeve për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë edhe në dy komunat e tjera në veri, përkatësisht në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq. Dushan Vuksanoviq, anëtar i grupit nisimtar për iniciimin e peticionit në Zveçan, tha se mbledhja e nënshkrimeve për peticionin ka nisur mëngjesin e 19 janarit, duke shtuar se pret që brenda afatit të caktuar kohor të mbledhen nënshkrimet e nevojshme. Siç raporton ekipi i “Radios Evropa e Lirë”, në Zveçan është parë një numër i madh i qytetarëve duke nënshkruar peticionin, në mesin e tyre edhe përfaqësues të Listës Serbe, partisë



më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila ka mbështetjen e Beogradit. Ndërkaq, kur ekipi i “REL”-it vizitoi Zubin Potokut, para vendit të caktuar për nënshkrimin e peticionit kishte pak persona. Sërhan Vuçiniq, një nga iniciatorët e peticionit në Zubin Potok, tha se kryetari shqiptarë nuk mund t’i përfaqësojë serbët që përbëjnë shumicën në këtë komunë. “Ne do të përdorim të drejtën tonë

demokratike për ta zëvendësuar atë. Fakti është se kryetari aktual është zgjedhur me disa qindra vota dhe nuk mund të na përfaqësojë”, tha ai. Ai shtoi se në mëngjesin e 19 janarit ka pasur shumë qytetarë që e kanë nënshkruar peticionin dhe pret që ky trend të vazhdojë edhe në ditët në vijim. Që peticioni të jetë i suksesshëm, kërkohet që të mbledhen së paku 20 për qind e nënshkrimeve nga numri i

përgjithshëm i votuesve të regjistruar. Kjo nënkupton se në Zubin Potok duhet të mbledhen 1 347 nënshkrime, ndërkaq peticionin në Zveçan duhet ta nënshkruajnë 1 411. Në Mitrovicë të Veriut kërkohen të paktën 3 640 nënshkrime dhe në Leposaviq 2 689. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, javën e kaluar deklaroi se qytetarët e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit dhe Zubin Potokut kanë afat që deri më 22 janar t’i mbledhin nënshkrimet e nevojshme për peticionin. Ai shtoi se afati për qytetarët e Zveçanit është më i gjatë për pesë ditë për shkak se në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është dorëzuar më vonë kërkesa për listën me numrin e saktë të votuesve të regjistruar në këtë komunë. Peticioni për shkarkimin e kryetarit të komunës po mbahet në bazë të Udhëzimit Administrativ që Qeveria e Kosovës e miratoi shtatorin e vitit të

kaluar për t’i hapur rrugë shpalljes së zgjedhjeve lokale në komunat në veri, pasi serbët lokalë nuk po i pranojnë kryetarët shqiptarë. Serbët kishin bojkotuar zgjedhjet e prillit të kaluar, në të cilat u zgjodhën kryetarët e rinj shqiptarë. Nisja e mandatit të tyre në fund të majit rriti tensionet në veriun e Kosovës. Më pas, komuniteti ndërkombëtar kërkoi shtensionimin e tensioneve dhe bëri thirrje për mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Nëse KQZ-ja konfirmon se peticioni ka qenë i suksesshëm, më pas organizohet votimi për shkarkimin e kryetarëve. Ky votim duhet të mbahet brenda 45 ditësh. Që ky votim të jetë i suksesshëm, kërkohen 50 për qind, plus një votë e qytetarëve me të drejtë vote. Më pas, rezultati i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka afat 30 deri në 45 ditë t’i shpallë zgjedhjet e parakohshme.

drejtua edhe zëvendësambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, Paul O’Connor, i cili u shpreh i kënaqur që Kosova ka përkrahur dhe ka demonstruar solidaritet të plotë me Ukrainën dhe popullin ukrainas që nga fillimi i luftës. Gjithashtu, ai u shpreh i kënaqur me pjesëmarrjen e FSK-së në këtë operacion vital në ndihmë të Ukrainës, dhe falënderoi ministrin Maqedonci, gjeneral Jasharin, pjesëtarët e kontingjentit pjesëmarrës në këtë operacion dhe të gjithë të përfshirët nga të dyja vendet, të cilët kanë

mundësuar zhvillimin e këtij partneriteti. Operacioni “Interfex” zhvillohet në Mbretërinë e Bashkuar dhe ka për qëllim trajnimin e trupave të ushtrisë së Ukrainës. Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja kanë ofruar gatishmërinë të angazhojnë instruktorë për ta ndihmuar procesin e stërvitjes së Ushtrisë ukrainase në kuadër të këtij operacioni. Ky angazhim i Forcës së Sigurisë së Kosovës është në linjë me qëndrimin e institucioneve të Kosovës në mbështetje të popullit dhe luftës së drejtë të Ukrainës.



Reagim i KMDLNj-së

Trajtim dhe përfundim i padinjitetshëm i kryetarëve të komunave në veri të Kosovës

Pas dorëheqjes së kryetarëve serbë në komunat Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok u organizuan zgjedhjet lokale për këto komuna që prodhuan një rezultat të mbështetur në Ligjin për zgjedhje por jo edhe mbështetur në realitetin ekzistues. Pasi serbët refuzuan të marrin pjesë në zgjedhje, me një përqindje qesharake u zgjodhën kryetarët që nuk përfaqësonin as 1 për qind të votuesve. Për Mitrovicën e Veriut u zgjodh Erden Atiq, për Leposaviqin, Lulzim Hetemi që të dy nga LV-ja kurse në Zveçan u zgjodh Ilir Peci i PDK-së sikur që në Zubon Potok u zgjodh Izmir Zeqiri, gjithashtu i PDK-së. Që nga zgjedhja e tyre filluan të kërkojnë mënyrat se si të largohen për faktin se qytetarët nuk i pranonin si kryetarë të tyre e as ndërkombëtarët. Në mungesë të stafit i mbushën komunat me familjarë dhe militantë partiakë. Kryetarët e



LV-së trajtoheshin mirë nga qeveria përmes vizitave të shpeshta të ministrave dhe aktivistëve partiakë ndërsa Lulzim Beqirin e shndërruan në figurë tragjiko - komike duke ia futur në kokë bindjen se ai është qendra e botës. Midis dy mundësive: 1. i dhënies së dorëheqjes dhe 2. shkarkimi përmes peticionit të 20 për qind të votuesve, qeveria e Kosovës

përmes një ministri jokompetent, atij të pushtetit lokal u përcaktua për nënshkrimin e peticionit në ndërkohë që kryetarët nga radhët e PDK-së ishin për dorëheqje, pas një marrëveshjeje politike. Nënshkrimi i peticionit ka filluar dhe po udhëhiqet nga Lista Serbe, me një kryetar tjetër por se përmbajtësisht nuk ka prodhuar asnjë ndryshim. Nga

aspekti ligjor, nga aspekti i të drejtave të njeriut nuk është normale e as e pranueshme që 2-3 për qind të votuesve të imponojnë vullnetin dhe përfaqësimin 97 për qind të popullatës aq më parë që të njëjtat forca politike do të kthehen në pushtet në këto komuna pas zgjedhjeve lokale që do të mbahen. KMDLNj e sheh si humbje kohe qeverisjen në këto komuna në kundërshtim me vullnetin e shumicës absolute dhe e quan të dyshimtë shtrirjen e sovranitetit ekskluzivisht me forca policore në kohën kur atje nuk ka prokurorë, gjykatës, policë dhe as administratë që përfaqëson shumicën. Atje duhet të gjendet një zgjidhje politike e pranueshme nga të gjithë qytetarët, pa dallim në baza nacionale dhe të tjera. Qetësia aktuale në veri të Kosovës është mashtruese dhe po menaxhohet nga Beogradi. Vendosija e sanksioneve për Kosovën

kryesisht ndërlidhet me Veriun dhe për fat të keq për faktin se Kosova po konsiderohet si faktor destabilizues. Institucionet e Kosovës duhet t'i trajtojnë qytetarët në veri të Kosovës njëjtë, pa i diskriminuar në baza etnike sikur që është pagesa e rrymës dhe shërbimeve tjera. Institucionet e Kosovës duhet të nxjerrin mësimin e nevojshëm nga aventura politike me 4 kryetarë në veri të cilët vet i futi në flakë dhe vet po i djegë dike mos e respektuar as minimumin e dinjitetit. Demokracia ka rregulla të qarta dhe të drejtat e njeriut nuk janë ato çka parashihi në dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare por sa ato zbatohen në praktikë. Çfarëdo diskriminimi qoftë edhe ai pozitiv është në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Për situatën në Veri të Kosovës përgjegjësi e madhe shkon në adresë të ndërkombëtarëve që po mbajnë qëndrim oportunist ndaj Serbisë.

Policia pranon donacion vetura dhe pajisje teknologjike nga ambasada gjermane

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 19 janar - Të premtën në ceremoninë zyrtare, në të cilën morën pjesë drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, si dhe menaxhmenti i lartë i PK-së, u nënshkrua pranim-dorëzimi i donacionit me vetura si dhe pajisje të teknologjisë për Policinë e Kosovës nga shteti gjerman, gjegjësisht Ambasada e Gjermanisë në Kosovë. Drejtori i përgjithshëm, kolonel Hoxha, tha se Policia e Kosovës i është mirënjohëse Ambasadës së Gjermanisë për përkrahjen e vazhdueshme për Policinë e Kosovës dhe për

avancimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve operacionale, logjistike dhe të teknologjisë. "Përkrahja nga partneret tanë ndërkombëtarë do të ndikojë në mënyrë pozitive në luftimin e të gjitha akteve kriminale. Do të ndihmojë drejtpërsëdrejti në kryerjen e aktiviteteve policore në terren si dhe do ta rrisë efikasitetin e punës policore në shumë fushëveprime", ka thënë Hoxha.

Ambasadori i Gjermanisë, Joern Rohde, ka theksuar se automjetet dhe pajisjet e dhuruara janë pjesë e një bashkëpunimi brenda të cilit Policia Federale Gjermane ndan teknologjinë më moderne dhe taktikat hulumtuese, duke e forcuar përkushtimin e Kosovës për t'i



siguruar kufijtë e saj dhe për të kontribuar në sigurinë e të gjithë rajonit. Ambasada e Republikës së Gjermanisë si partner i

përhershëm i Policisë së Kosovës gjatë dy viteve të fundit 2022 dhe 2023 ka përkrahur Policinë e Kosovës, më konkretisht Policinë

Kufitare me ngritje të kapaciteteve operacionale dhe logjistike me 59 vetura, 5 kombibus dhe 10 motorë të terrenit në fushën e teknologjisë informative me 130 kompjuter, 16 lloptopë, laboratorë për pikën kufitare Hani i Elezit, projektorë, pajisje të ndryshme për kontrollimin e dokumenteve dhe skenimin e veturave gjatë kontrollit në kufi, dylbi, kamera termike, detektor për identifikim të njerëzve dhe pajisje të tjera. Po ashtu një kontribut të veçantë nga Ambasada e Gjermanisë, policia kufitare ka pranuar për ngritjen edhe të kapaciteteve të burimeve njerëzore, ku janë mbajtur 20 trajnime të ndryshme me pjesëmarrje të mbi 150 zyrtarëve policorë.

Kosova dhe Malta nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e kulturës

PRISHTINË, 19 JANAR - Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit kulturor në mes të Kosovës dhe Maltës është nënshkruar marrëveshja në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë dhe Ministrisë së Trashëgimisë Kombëtare, Arteve dhe Qeverisjes Lokale në Maltë. MKRS-ja ka njoftuar se ky bashkëpunim synon partneritet në fushat e kulturës, trashëgimisë kulturore, muzikës dhe vallëzimit. Në kulturë përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve të

bashkëpunimit, shkëmbimeve kulturore dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve kulturore, organizatave dhe individëve në të dyja vendet. Në muzikë e vallëzim, ndër të tjera, përmes prezantimit të punës së kompozitorëve e muzikantëve, organizatave, institucioneve, orkestrave në të dyja shtetet dhe shkëmbimit të përvojave mes tyre. Gjithashtu, në fushën e trashëgimisë kulturore, ku parashihet shkëmbimi profesional i ekspertëve në

menaxhimin e objekteve të trashëgimisë, ekspertëve përgjegjës për planet e menaxhimit, shkëmbim profesional në nivelin e politikave të ruajtjes për zonat e trashëgimisë kulturore me vëmendje të veçantë. Marrëveshja është nënshkruar nga ambasadorja e Kosovës në Itali, Maltë dhe San Marino, Lendita Haxhitasim dhe sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Trashëgimisë Kombëtare, Arteve dhe Qeverisjes Lokale në Maltë, Kevin Mahoney.



“Lajçaku i mirë, Lajçaku i keq”, Çitaku e ashpër me liderët institucionalë: Jeni joseriozë dhe të

PRISHTINË, 19 JANAR - Nën kryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka kritikuar liderët institucionalë për ndryshim të qëndrimeve në raport me dialogun Kosovë - Serbi. Ajo ka vlerësuar se kjo i bënë ata joseriozë, të papërgjegjshëm dhe qesharakë. “Është i mirë propozimi i BE-së për

asociacionin; Jo nuk është i mirë propozimi i BE-së; E kemi pranuar propozimin e BE-së; Nuk e kemi pranuar propozimin e BE-së; S’ka autonomi për serbët e Kosovës; Ka autonomi për serbët e Kosovës; Lajçak është i mirë; Lajçak është i keq; Ju jeni joserioz, të papërgjegjshëm, qesharak. E fatkeqësisht për shkak të pozitave institucionale që

mbani, ju jeni të dëmshëm”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”. Reagimi i Çitakut ka ardhur pas deklaratës së ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, e cila ka thënë se emisari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, është i dështuar në këtë proces.



Zyrtari i lartë i NATO-s: Perëndimi duhet të përgatitet për luftë me Rusinë

PRISHTINË, 19 JANAR - NATO ka paralajmëruar se Perëndimi duhet t’i rrisë përgatitjet për ngjarje të papritura, përfshirë një luftë me Rusinë, përderisa pushtimi rus i Ukrainës po i afrohet përvjetorit të dytë, në mes të indikacioneve për lodhje politike të disa aleatëve perëndimorë të Kievit. “Ne duhet ta kuptojmë se nuk është e mirëqenë që jemi në paqe. Prandaj, ne [forcat e NATO-s] po përgatitemi për një konflikt me Rusinë”, tha admiral holandez Rob Bauer. Këto deklarata shefi i komitetit ushtarak të NATO-s i bëri në Bruksel para nisjes së stërvitjeve më të mëdha të aleancës ushtarake perëndimore që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Aleanca duhet të jetë në gatishmëri të lartë për luftë dhe “ta presë të papriturën”, tha Bauer, duke shtuar se “në mënyrë që të jemi plotësisht efektivë, po



ashtu në të ardhmen, na duhet transformimi luftarak i NATO-s”. Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, po ashtu ka

paralajmëruar se lufta në Ukrainë mund të zgjerohet në shtetet fqinje. “Ne pothuajse çdo ditë dëgjojmë kërcënime nga

Kremlini, së fundi kundër miqve tanë në shtetet baltike”, tha Pistorius për gazetën “Tagesspiegel” më 19 janar.

Për ta rritur përgatitjen, NATO do t’i nisë muajin e ardhshëm stërvitjet Steadfast Defender 2024, që do të zgjasin përgjatë majit. Në këto stërvitje do të përfshihen afër 90 000 trupa, të cilat do t’i stërvitin planet rajonale të aleancës. Stërvitja “do të tregojë se NATO mund të kryejë operacione të qëndrueshme dhe të ndërlikuara në shumë fusha për disa muaj, përgjatë mijëra kilometrave, nga Veriu i Lartë në Evropën Qendrore dhe Lindore në çfarëdo kushte”, tha aleanca pre 31-anëtarësh. Përderisa vija e frontit në lindje të Ukrainës ka mbetur gjerësisht e pandryshuar për muaj të tërë, Rusia ka vazhduar t’i sulmojë qytetet ukrainase me dronë dhe raketa lundruese. Ndërkaq Kiev, që po përballet me pushtimin rus që nga shkurti i vitit 2022, ka sulmuar caqet ekonomike dhe ushtarake në thellësi të Rusisë.

DnV kërkon trajtim të shpejtë të kushtetutshmërisë së Ligjit për Zgjedhje lidhur me kuotën gjinore



PRISHTINË, 19 JANAR - “Demokracia në Veprim” (DnV) e vlerëson pozitiv vendimin e Institucionit të Avokatit të Popullit për ta sfiduar kushtetutshmërinë e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme lidhur me çështjen e kuotës gjinore prej 30 %. Në fakt, prej shumë kohësh DnV kishte konsideruar se kuota prej 30 % nuk është në frymën kushtetuese të barazisë gjinore si dhe nuk mundëson garë të barabartë zgjedhore mes grave

dhe burrave. Partitë politike janë mjaftuar zakonisht me zbatimin e pragut minimal prej 30 %, duke mos promovuar pjesëmarrje të barabartë të të dy gjinive. DnV beson që modeli ‘zebër’ - ku çdo i dyti kandidat në listë është i gjinisë tjetër - është zgjidhja që duhet ndjekur në mënyrë që parimet dhe vlerat kushtetuese të barazisë gjinore të mishërohen edhe në legjislacionin zgjedhor.

Po ashtu, DnV kërkon nga Gjykata Kushtetuese trajtim meritot të kësaj kërkesë brenda afateve sa më optimale kohore - duke pasur parasysh që pjesa e dytë e këtij viti mund ta gjejë Kosovën me datë të zgjedhjeve të rregullta parlamentare. Në këtë mënyrë do të evitoheshin pasiguritë në lidhje me zbatimin e Ligjit për Zgjedhje sa i përket pjesës së listave të subjekteve politike.

Osmani dhe Hovenieri diskutojnë për miratimin e shitjes së pajisjeve ushtarake nga ShBA-ja

PRISHTINË, 19 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim të rregullt ambasadorin e ShBA-së, Jeffrey Hovenier. Në këtë takim u diskutua për zhvillimet e fundit në vend si dhe ato në rrafshin e bashkëpunimit bilateral. Në fokus të veçantë gjatë këtij takimi ishte miratimi i

Programit të Shitjeve Ushtarake nga Departamenti i Shtetit të ShBA-së. Me këtë rast, presidentja Osmani e falënderoi ambasadorin Hovenier për angazhimin e tij të vazhdueshëm dhe vlerësoi lart punën e institucioneve në të dyja anët. Presidentja Osmani dhe

ambasadori Hovenier diskutuan edhe për një sërë çështjesh të tjera të interesit të përbashkët dhe rikonfirmuan nevojën dhe gatishmërinë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të vazhdueshëm me qëllim të përmbushjes së objektivave të përbashkëta.



AKB-ja: Mbi 1 600 biznese u mbyllën në vitin 2023 në Kosovë

Prishtinë, 19 janar - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) vlerëson se viti 2023 ishte sfidues për Kosovën si në aspektin ekonomik, politik, integruar dhe në atë të sigurisë. “Ekonomia kishte rënie të zhvillimit në krahasim me vitet paraprake si në investime, investime kapitale, eksporte

dhe kishte shuarje të bizneseve”, thuhet në njoftimin e AKB-së. “AKB-ja ka njoftuar se në bazë të të dhënave që ka, në vitin 2023 u mbyllën mbi 1 600 biznese të sektorëve të ndryshëm nga të gjitha regionet dhe komunat e Kosovës. Këto kompani kishin mesatarisht 1-4

punëtorë ku mbetën pa punë rreth 5 000 punëtorë”, thekson AKB-ja. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka vlerësuar se trendi i hapjes dhe i mbylljes së bizneseve në Kosovë gjatë tri viteve të fundit ishte mesatarisht i njëjtë rreth 11 000 biznese të hapura dhe mbi 1 600 të mbyllura.



Dhoma e Tregtisë përshëndet vendimin e BQK-së për mospranimin e valutave të tjera përveç euros

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 19 janar - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë ka përshëndetur vendimin e fundit të marrë nga Banka Qendrore e Kosovës për ndalimin e përdorimit të një valute të huaj në Republikën e Kosovës. “Fatkeqësisht, përdorimi i mëtutjeshëm i dinarit serb nëpër komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës tani e 25 vjet ka shkaktuar dhe po i shkaktonte dëme qindramilionëshe buxhetit të Kosovës, pasi asnjë nga shitjet të cilat bëhen përmes kësaj valute nuk deklarohen në Administratën Tatimore të Kosovës. Përveç kësaj, sipas legjislacionit në fuqi, përdorimi i dinarit është antiligjor dhe antikushtetues”, është thënë në njoftimin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë. Nga 1 shkurti 2024, sipas Rregullores për Operacionet me Para të Gatshme, valuta e vetme e



lejuar të përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave me para të gatshme dhe në sistemin e pagesave në Republikën e Kosovës është euro si valutë e vetme. “Aktualisht janë mbi 50 mijë qytetarë serbë të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe pensionistët, të cilët paguhen nga shteti i Serbisë në dinarë, ndërsa punojnë në institucione paralele të shëndetësisë, arsimit dhe kulturës që funksionojnë sipas

sistemit të Serbisë. Si Dhomë e Tregtisë konsiderojmë se ky vendim është shumë i mirëseardhur dhe i njëjti është dashur të aplikohet edhe më parë”, është theksuar në njoftimin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë. Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, ka theksuar se heqja e dinarit do të thotë “dëbim i serbëve pa përdorimin e armëve”. “Pas të gjitha formave të dhunës

BE-ja i kërkon sqarime Kosovës për vendimin e BQK-së

Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i shmangin veprimet e pakoordinuara të cilat nuk janë në frymën e normalizimit të raporteve dhe, siç thanë nga blloku, mund të ndikojnë negativisht në situatën në terren. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, duke iu përgjigjur pyetjeve lidhur me këtë vendim të BQK-së, që do të hyjë në fuqi më 1 shkurt, tha se blloku evropian ende është duke e analizuar këtë çështje. “Ne jemi ende duke e analizuar dhe duke

kërkuar sqarime për këtë vendim, motivet dhe implikimet që ai mund t'i ketë... Kosova dhe Serbia duhet t'i shmangin veprimet e pakoordinuara që nuk shkojnë në frymën e normalizimit të raporteve dhe që mund të kenë ndikim negativ në situatën në terren”, ka theksuar Stano. Ai përsëriti thirrjen për të dyja palët që edhe këtë çështje ta adresojnë në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve që ndërmjetësohet nga BE-ja.

institucionale që u përdorën kundër popullit serb nga regjimi autoritar i [kryeministrit të Kosovës, Albin] Kurti dhe pasi nuk arriti t'i dëbojë të gjithë serbët nga

Kosova, ai tani vendosi ta ndalojë dinarin në Kosovë dhe kështu ta kërcënojë drejtpërdrejt mbijetesën fizike të popullit serb”, është thënë në reagimin e Listës Serbe.

Hoti, qeverisë: Ndihma e njëhershme nuk është zgjidhje për inflacionin



PRISHTINË, 19 JANAR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka theksuar se ndihma e njëhershme nuk është zgjidhje për zbutjen e pasojave të inflacionit në vend. Hoti duke iu referuar statistikave të ASK-së thotë se 43.4 % e familjeve nuk mund të përballojnë një shpenzim të papritur prej 100 eurove nga burimet e tyre vetjake. “Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 43.4 % e familjeve nuk mund të përballojnë një shpenzim të papritur prej 100 eurove nga burimet e tyre vetjake; 49.2 % e

familjeve nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet e një shujte çdo dy ditë që përfshinë mishin, pulën dhe peshkun; 48.8 % e familjeve kanë deklaruar se pagesa e borxheve është barrë e rëndë financiare; 8.1 % e familjeve kishin vështirësi të mëdha, ndërkaj 20.1 % përballeshin me vështirësi për kryerjen e pagesave të nevojshme të zakonshme të familjes, marrë parasysh të ardhurat. Shkaktari burimor i kësaj situatë është inflacioni”, ka thënë Hoti, duke shtuar se thellimi i krizës erdhi si rezultat i mungesës së masave adekuate për t'i zbutur pasojat e

inflacionit për familjet. “E kemi ngritur vazhdimisht në Kuvend dhe jashtë Kuvendit, se ndihma e njëhershme nuk është zgjidhje për zbutjen e pasojave të inflacionit. Tani këtë po e dëshmojnë statistikave të qeverisë. Zgjidhja është: (1) indeksimi i pensioneve dhe asistencës sociale, së paku aq sa ka qenë inflacioni, në mënyrë që të ruhet standardi minimal i jetës së familjeve më të cënueshme nga inflacioni; si dhe (2) zgjerimi i përkohshëm i listës së mallrave me normë të reduktuar të TVSh-së prej 8-përqindësh”, ka deklaruar Hoti.

Policia konfiskon monedha metalike mbi 2 600 euro në Fushë-Kosovë

Prishtinë, 19 janar - Një person nga Fushë-Kosova ka raportuar në Policinë e Kosovës se disa persona kanë deponuar monedha metalike me nga dy dhe një euro në vlerë 2 619 euro, që dyshohet se janë të falsifikuara. Sipas njoftimit të

Policisë së Kosovës, monedhat janë konfiskuar për procedura hetimore. Nga janari deri në shtator të vitit 2023 në laboratorin e Agjencisë së Forenzikës janë ekzaminuar mbi 35 000 monedha të falsifikuara dhe 2

209 kartëmonedha të falsifikuara. Më të falsifikuarat, sipas ekspertëve të forenzikës, janë monedha prej 2 eurosh dhe kartëmonedha prej 50 eurosh. Kosova nuk është pjesë e Eurozonës, por përdor euron. Nga

shtetet e tjera të rajonit, ashtu vepron edhe Mali i Zi. Me Kodin Penal të Kosovës, kushdo që prodhon, vë në qarkullim, transporton, pranon, përdor ose ka para të falsifikuara, me qëllim që t'i vendosë në qarkullim si të vërteta,



dënohet prej 1 deri në dhjetë vjet burgim.

Ndëshkimi i Ben Blushit si komplotist

Nga: Lorenc VANGJELI

Shqipëria e errët e diktaturës kishte shumë më shumë shkrimtarë sesa gazetarë të njohur. Përmbysja e madhe e ka ndryshuar edhe këtë raport: sot në Shqipëri ka shumë më shumë gazetarë të njohur sesa shkrimtarë të tillë. Fastfudi [Fast food] i fjalës ka zëvendësuar kuzhinën e metaforës. Dhe, ky nuk është thjesht fatalitet i kohës së çmendur ku jetojmë; nuk është thjesht klithma e stomakut që kërkon ushqimin e shpejtë të përditshëm, por është vetë koha që me fatalitetin e saj ka ekzekutuar dhjetëra projekt-shkrimtarë të panjohur e ëndrra letërsie duke i vrarë Shqipërisë shumë shkrimtarë të mirë e duke i konvertuar ata në gazetarë të shkëlqyer. Njëlloj si të krishterët e dikurshëm të Arbërisë së Kastriotit të lavdishëm, që duke sakrifikuar një copëz lëkure nga trupi, u kthyen nga Kristo në Sulejman e duke festuar në vend të Krishtlindjeve, Bajramin e bekuar.

Askush nuk e di se sa romane janë groposur të gjallë në ndërgjegje njerëzore, sa poezi janë dreqosur në këmbim të prozës së mërzitshme të artikujve, sa dashuri të përjetshme janë rroposur nën rrogosin e ashpër të urrejtjes për politikën e përkohshme të ditës. Askush nuk e di sa ka kushtuar kursi i këmbimit të një libri me shumë artikuj gazetash, por gjithkush e di se gazetatat dikur dhe ekranet e televizionit sot, këmben me shumë më shumë para, pushtet të errët, vila plot diell apo makina me targa të personalizuar si të çunave të Londrës. Madje, me cilindratë më të madhe se makinat e tyre, por me të njëjtin vanitet si ata. Mes këtyre dy skajeve, diku në mes, si kufijtë mes vendeve të BE-së që ekzistojnë si ndarje, por kanë humbur si praktikë doganieri; në limbon e ndërmjetme janë ca pak emra shqiptarësh të njohur që i bëjnë të dyja. Edhe shkrimtarin edhe gazetarin. Madje, dikush si Ben Blushi bëjnë, në ndërkohë, edhe politikanin në mes. E, meqë ra fjala tek artizani i fjalës Ben Blushi, ai i ka bërë me kohë të plëshme të tri këto zanate nga të cilat vetëm njëri prej tyre mund t'i gëzohet trashëgimisë së dikurshme para e postkomuniste. Nga dy të tjerat: politika, edhe pse me kravata mëndafshi dhe kostume të personalizuar, nuk ka ndonjë ndryshim domethënës nga ajo që ka lënë pas e shkuara. Në një shumicë tmerruese, kostumet e sotëm janë njëlloj me pëlhurat gri që mumifikonin ish-revolucionarët e dikurshëm të byrosë me Enver Hoxhën mbi kokë e që nuk ishin të gjendje të kuptonin se kishin vdekur, ndonëse ishin njëkohësisht në



gjendje të kryenin nevojat fiziologjike si ushqimi e defektimi. Tjetra: gazetaria, mbas vullit idealist dhe moralist të viteve 1930 apo fillimit të viteve 1990, është shndërruar në një kamarierrllëk brutal duke u këmbyer me një pjatë dhembshurisht bosh që i serviret interesit vetjak sot, njëlloj si prostitucionit. “Le t’ia hipin atë që paguan më parë”! I endur mes tri zanateve, me artikuj të dikurshëm që nuk i kujton më as vetë, me akte politike që pak ia kujtojnë në Tiranë, si shkrimtar Ben Blushi ka krijuar një kolanë vetjake librash befasues si për të kujtuar diferencën mes tyre. \ Politika shkruan historinë, gazetaria është në thelb histori e shkruar në çast, kurse letërsia e krijon vetë botën e saj në të cilën shkrimtari është zot. Letërsia është vullneti i epërm që bën bashkë apo divorcon një çift, është vendimi për kë lind e kush ka radhën për të vdekur, është krijuesi që kur nuk i pëlqen çfarë sheh rrotull, shpik një botë alternative ku fton në census cilindo që ia lyp dëshira vetjake. Apo, edhe më shumë, bashkë me gjithë këto, krijon edhe një botë të kithtë të së ardhmes, banorët e të cilës ende nuk kanë lindur, por që mund të detyrohen të jetojnë pikërisht aty. Romani i fundit në radhë, Komploti i botimeve Pegi, ka zgjedhur këtë identikit bote të ardhshme, të cilën vetë autori refuzon ta pranojë. E afron si mundësi, por i lutet gjithkujt që ka në dorë ta pengojë sendërtimin e saj, shmangien e ngjarjeve të këtij romani. Që të mos ndodhin vërtet. Në libër është Shqipëria e vitit 2043, ku një sërë ngjarjesh të lidhura me njëra-tjetrën sipas rendit shkak-pasojë dhe duke e shndërruar çdo shkak në pasojë dhe më pas, edhe pasojën e radhës e rimishëron në një shkak

të ri të mbetur me barrë nga pasoja vijuese. Sërish sipas rendit: politikanët shkruajnë historinë, gazetarët e dokumentojnë atë, kurse shkrimtari, si Zoti, krijon vetë botën. Nuk është një Shqipëri më e bukur në libër. As më e fortë. As më e ndershme dhe as më e drejtë. Është një Shqipëri e cila qeveriset nga afganët e bërë papritur gjysma e popullsisë në vend mbasi kishin ardhur në Shëngjnin e bukur si një grusht emigrantësh të drobitur lufte, por natyrisht të paafte t'i bëjnë Shqipërisë ato lemeri që nuk ia ka bërë as pushtuesit më të egër. Edhe afganët u dëshmuan të paafte ta trajtojnë Shqipërinë aq mizorisht sa e kanë trajtuar vetë shqiptarët. Anarkia dhe mbretëria e kaosit, hierarkia e përmbysur në një vend që njeh si perëndi të vetme paranë; ideologjia e gënjeshtërt dhe urrejtja pa shkak që rritet si kaktus në këtë vend nën diellin e mrekullueshëm të Mesdheut; provincializmi harbut dhe harbutët që refuzojnë të mësojnë të sillen me zotnillik; turma me instinkt të verbër që drejton instinktivisht vullnetin e individëve që i sheh të ndryshëm; soji më fatkeq i budallenjve që janë edhe më shumë të tillë sepe kanë fatin të mos e kuptojnë që janë budallenj, shto këtu natyrisht edhe hebrenjtë që nuk mungojnë kurrë mbas çdo teorie konspirative dhe miqësitë e mëdha me të fuqishmit e kësaj bote që kanë qenë tempujt e vetëm ku faleshin maskarenjtë e të gjitha ngjyrave që flisnin shqip që në lindje ... pra, të gjitha këto bashkë me revanshin e autorit që kujton jetën e vet, janë të gjitha kanavaca dhe korniza e një pikturë të ashpër të Shqipërisë së dy dekadave më pas, që Ben Blushi e skicon bardhezi faqe pas faqeje në libër. Me një stil të vrazhdë, pa

ornamente, por me shije reportazhi, me personazhe që edhe pse të ndryshëm janë njëlloj të ngjashëm si gurët e shahut, Blushi vë bast me fantazinë e lexuesit të cilin e sfidon që mbas çdo sajese të vë bast se çfarë do të sajojë më pas. Duke ndjekur logjikën e Blushit, vargu i sikurve që ai i trajton fillimisht si shkaqe që nuk mundin të abortojnë pasojën e radhës, është një ftesë për ta parë dhe të nesërmen hipotetike të vendit, si një rresht sikuresh që mund të nisnin. Fjala vjen, me ata 30 e kusur vezirë të mëdhenj të Perandorisë Osmane që sikur t'i ishin falur klithmës së gjakut dhe jo vetë perandorisë si fe; sikur anesë së Enverit t'i kishte dhembur koka mjaftueshëm për ta shmangur të shoqin mbi vete në atë shkurt të ftohtë Gjirokastre në vitin 1908 e të mos kishte mbetur me barrë më diktatorin e ardhshëm; sikur diktatori Adolf i gjermanëve të kishte dëgjuar Rauf Ficon që të kishte pushtuar Shqipërinë dhe jo Bashkimin Sovjetik; sikur turqit të kishin pushtuar më parë Vjenën dhe të mos vinin fare në Krujë; sikur Mehmeti i shqiptarëve, ai burri me mustaqe që ishte luan me të dobët dhe lepurush me Hoxhën ta kishte qëlluar Enverin në një nga pushimet e seancave të kongresit të shtatë të PPSH-së ... e shumë sikure të tjera që mund të vazhdojnë pafund, por pa përjashtuar sidomos njërin prej tyre: sikur Ramiz Alia, të kishte çuar Fatos Nanon të paqetohej me studentët dhe të mbante Sali Berishën për partinë e tij, atëherë, me siguri, Pandi Majko do të vazhdonte të ishte sekretari i parë i rinisë socialiste në vend. Dhe, më pas nuk do të ishin as Majko me flokë të bardhë dhe as afgani Mohamed me dhëmbë shkëlqyes – personazh i Blushit – ministra të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë: i pari

veteran i luftës së Kosovës, i dyti i gatshëm t'i vinte hakut nonave të serbëve. Konvertimi i dhembshëm i çdo halle lozonjare me një xhaxha të ngrysur është i pamundur. Ashtu siç është e pamundur të imagjinohet se si do të ishte Shqipëria sikur politika e saj në këto tre dekada e kusur pluralizëm të ishte thjesht normale. Blushi vetë i bën llogaritë e tij cinike me anormalitetin e saj. Në romanin e tij të fundmë, Komploti, ai nuk e thotë një gjë të tillë. Blushi vazhdon me sikuret e tij dhe fton në botën groteske që krijon vetë e në të cilën, në forma të ndryshme, shqiptarët do të jenë të dënuar të jetojnë sa kohë që edhe ca pak individë të mençur do të vazhdojnë t'i binden instinktit të turmës, sa kohë që urrejtja do të vazhdojë të jetë instrumenti që shpjegon gjithë botën tonë të vogël dhe sa kohë që do të refuzojmë të rritemi duke refuzuar të pranojmë sa të vegjël e të parëndësishëm jemi në një botë të madhe përtej nesh. Por, mbi të gjitha, nëse vazhdojmë t'i përulemi ligjësi të një bote që pranon pa mëdyshje që hallati më krenar mashkullor në Tiranë vazhdon të jetë Range Roveri i modelit të fundit. Shkrimtarët paralajmërojnë, por shkrimtarët nuk kanë faj kur nuk i dëgjon dynjaja. Për këtë arsye, për këtë mëkat që nuk vjen prej tyre, ata duhen ndëshkuar si komplotistë edhe kur thonë të vërtetën. Në botën e gënjeshtërt, e vërteta është krim. Blushi shkroi dhe e pranoi krimin e tij. Ai duhet ndëshkuar edhe pse si shkrimtar më pak i njohur sesa si politikan dhe gazetar, e sheh veten ndihmës të Zotit, edhe vetëm pse guxoi të bëjë me hakmarrje, revansh e urrejtje të njëjtën punë që Krijuesi i Pavdekshëm e bën me dashuri!

Egoizmi i flet të gjitha gjuhët dhe i luan të gjitha rolet – edhe atë të zemërgjerësisë

Thënie të moralistit francez François de La Rochefoucauld (1613–1680)
– Secili nga ne ka mjaft forcë për të përballuar fatkeqësitë e të tjerëve.

– Për të pasur sukses duhet të bëjmë çmos që të shfaqemi si njerëz të suksesshëm.

– Urtësia është për shpirtin si shëndeti për trupin.

– Ferri i grave është pleqëria.

– Ai, të cilit i besoni sekretin tuaj, ai bëhet pronari i lirisë suaj.

– Asgjë nuk jepet me aq bujari sa këshillat.

– Grindjet nuk do të zgjasnin shumë, nëse faji do të ishte vetëm i njëjës palë.

– Xhelozia lind gjithmonë me dashurinë, por jo gjithmonë vdes me të.

– Virtytet treten në interes si lumenjtë në det.

– Kur veset na braktisin, mburremi se i braktisëm ne.

– Pjesa më e madhe e femrave të ndershme janë thesare të fshehta e të sigurta, ngaqë askush nuk i kërkon.

– Është më turp të mos u besosh miqve sesa të gënjehesh prej tyre.

– Tradhtohet më shpesh prej dobësisë sesa prej dëshirës për të tradhtuar.

– Mund të jesh më dinak se një tjetër, por jo më dinak se gjithë të tjerët.

– Në dashuri, shërohet më mirë ai që shërohet më shpejt.

– Më lehtë heqim dorë nga interesi ynë sesa nga shijet tona.

– Është më kollaj të jemi të mençur për të tjerët se për veten.

– Sado që të na lëvdojnë, asgjë të re s'na mësojnë.

– Atij që s'i pëlqen askush është më i palumtur se ai që nuk pëlqehet nga askush.

– Guximi i vërtetë është të bëjmë pa pasur asnjë dëshmitar atë jemi të gatshëm të bëjmë në sytë e botës.


– Rinia i ndryshon shijet ngaqë i vlon gjaku, ndërsa pleqëria i ruan shijet prej forcës së zakonit.

– Pendesa jonë nuk vjen dhe aq nga keqardhja ndaj të keqes që kemi bërë, sa nga frika e asaj që mund të rrjedhë prej saj.

– Kujdesi dhe dashuria nuk bëjnë për njëri-tjetrin. Ndërsa dashuria rritet, kujdesi zvogëlohet.

– Mënyra më e mirë për t'i mbajtur miqtë është të mos u kërkojsh asgjë e të mos u detyrohesh asgjë.

– Të shumtë janë ata që puthin duart që do të donin të kafshonin.



– Rinia është një drithërimë e vazhdueshme, është gripi i arsyes.

– Një femre s'ka ç'i duhet të jetë e re pa qenë e bukur, as të jetë e bukur pa qenë e re.

– Mungesa i zbeh dashuritë e vogla dhe i rrit të mëdhatë, njësoj si era që shuan qiriun por ndez zjarrin.

– Nuk bëhesh qesharak për cilësitë që ke, por për ato që shtrësh sikur ke.

– Nëse akoma nuk është gjetur ana qesharake tek ndonjë individ, do të thotë nuk është kërkuar mjaftueshëm.

– Qartësia e vërtetë qëndron në të thënit e të nevojshmes dhe vetëm të nevojshmes.

– Premtimet e disave janë si rërat thithëse, të cilat, po t'i shohësh nga larg duken të qëndrueshme e të sigurta, por rezultojnë të paqëndrueshme dhe të rrezikshme.

– Përvujtëria është forma më keqe e mendjemadhësisë.

– Vetëm ai që është i denjë për përçmim ka frikë se mos e përçmojnë.

– Shpresa, për sa e gënjeshtërt është, të paktën shërben për të na çuar drejt vdekjes për një rrugë të pëlqyeshme.

– Ka më shumë rëndësi të studiohen njerëzit se librat.

– Është çmenduri e madhe të duash të jesh i vetmi i mençur.

– Ka çmenduri që përhapen si sëmundje ngjitëse.

– Egoizmi i flet të gjitha gjuhët dhe i luan të gjitha rolet, edhe atë të zemërgjerësisë.

– Para se të dëshirosh fort diçka, duhet të shikosh se sa i lumtur është ai që tashmë e zotëron atë.

– Mospranimi i lëvdatës nxjerr në pah dëshirën për t'u lëvduar dy herë.

– Mirënjohja është vetëm pritje për ndere të reja.

– Kush merret tepër me gjëra të vogla, bëhet i paaftë për gjëra të mëdha.

– Si mund të pretendosh që një tjetër të mbajë sekretin tënd, kur ti vetë, duke ia besuar atij, nuk ke ditur ta mbash?

– Heshtja është sjellja më e sigurt për atë që nuk ka vetëbesim.

– Nganjëherë mjafton të jesh injorant që të mos gënjehesh nga një njeri inteligjent.

– Mendjemadhësia e favorizon bisedën më shumë se intelijenca.

– Secili nga ne fal aq sa mund të dashurojë.

– Xhelozia ushqehet me dyshime dhe shndërrohet në tërbim, ose vdes në çastin që dyshimi kthehet në vërtetësi.

– Ka meritë pa sukses, por jo sukses pa ndonjë meritë.

– Virtyti s'do të shkonte larg, po të mos e shoqëronte sedra.

– Mosbesimi ynë justifikon mashtrimin e tjetrit.

– Njerëzit japin këshilla të mira kur janë shumë të vjetër për të dhënë shembull të keq.

– Mirënjohja është forma më e këndshme e mirësjelljes.

– Në xhelozia ka më shumë egoizëm se dashuri.

– Fati korrigjon shumë gabime që arsyeja nuk mundet.

– Në fatkeqësitë e miqve tanë gjejmë gjithmonë diçka që nuk është krejt e papëlqyer për ne.

– Njerëzit e ndershëm të japin respekt për meritat e tua, të tjerët për pasurinë tënde.

– Nuk ka njeri të mençur, pa një grimcë çmendurie.

– Parapëlqejmë më shumë që të flitet keq për ne sesa të mos flitet fare.

– Nëse njerëzit nuk do të lajkatoheshin respektivisht nuk do të kishte më shoqëri.

– Egoizmi është mikluesi më i madh.

– Nëse një njeri nuk gjen paqe tek vetja e vet, më kot e kërkon gjetkë.

– Vuajtja që i duhet shkaktuar vetes për t'i qëndruar besnik njeriut që do, nuk vlen më shumë se një tradhti.

– Miku i vërtetë është më e mira e të mirave.

– Të gjithë ankohen se nuk kanë kujtesë, askush nuk ankohet se nuk ka gjykim.

– Modestia, që duket sikur i refuzon lëvdatat, në të vërtetë veçse i dëshiron më të rafinuara.

– Ndonëse njerëzit lëvdohen për veprat e tyre të mëdha, ato nuk janë aq shpesh fryt i një projekti sa ç'janë pasojë e rastësisë.

– Është e vështirë që dy persona që nuk duhen më, të grinden me të vërtetë.

– Gjëja më e vështirë për të gjetur në lidhjet dashurore është dashuria.

– Liria e të shprehurit është një prej të drejtave më të vlerësuara të njeriut.

– Ka një lloj dashurie të vetme, por me mijëra versione të ndryshme.

– Nuk kemi guximin të pohojmë se jemi pa të meta, e që armiqtë tanë nuk kanë cilësi, por na duhet fare pak që ta besojmë.

– Lajka është një monedhë e rreme që qarkullon vetëm falë sqimës sonë.

– Mendja lejon gjithherë që të nëpërkëmbet nga zemra.

– Veset janë pjesë përbërëse e virtyteve siç janë helmet pjesë përbërëse e ilaceve.

– Shumë thonë që e përçmojnë pasurinë, por janë të paktë ata që ua japin të tjerëve.

– Kënaqësia e dashurisë është të dashurosh.

– Sinqeriteti gjendet në pak njerëz dhe shpeshherë është më i mprehti mashtrim, pasi disa tregohen të sinqertë që të fitojnë mirëbesimin dhe të depërtojnë në sekretet e tjetrit.

– Jemi të prirë të quajmë dëgjues të mirë vetëm ata që ndajnë të njëjtat mendime me ne.

– Shumë të rinj mendojnë se janë spontanë, ndërkohë që janë

thjesht të paedukatë.

– Bashkë me këshillat nuk mund të jepet dhe urtia për t'i ndjekur.

– Nuk dëshirohet kurrë me zell gjëja që dëshirohet vetëm përmes arsyes.

– Gjejmë gjykim të matur vetëm në ata persona që e mendojnë si ne.

– Shpesh, dhimbja që na shkaktojnë të tjerët, nuk është aq e madhe sa ajo që ne i shkaktojmë vetes.

– Shakaxhiu do të gjendej shpesh në siklet po të mungonin budallenjtë.

– Në jetë na ndodh të gjendemi në rrethana, në të cilat, për t'ia dalë, duhet të jemi pak të çmendur.

– Zakonisht njerëzit lëvdojnë që të lëvdohen.

– Kush mendon se mund t'ia dalë pa botën, gënjehet shumë; por kush mendon se bota nuk mund t'ia dalë pa të, gënjehet shumë më tepër.

– Zilia jonë zgjat më shumë se lumturia e atyre që kemi zili.

– Është më mirë ta përqendrojmë mendjen tonë në përballimin e fatkeqësive që na kanë ndodhur sesa në parashikimin e fatkeqësive që mund të na ndodhin.

– Pasionet janë të vetmit oratorë që joshin gjithmonë.

– Nuk jemi kurrë aq të lumtur apo të palumtur sa ç'mendohet.

– Qëndrojmë më gjatë me dashurinë e parë, kur s'është e thjeshtë të gjejmë një të dytë.

– Për të njohur mirë gjërat, duhet të njohim mirë detajet e tyre; por duke qenë se detajet janë pothuajse të pafundme, njohuritë tona janë gjithmonë sipërfaqësore dhe jo pa të meta.

– Ndershmëria e femrave është shpesh kujdes ndaj emrit dhe rehatisë së tyre.

– Pak njerëz dinë të jenë të moshuar.

– Në dashuri, të mos duash tepër është një mjet i sigurt për t'u dashur nga partneri.

– Një person i sjellshëm mund të dashurohet si një i çmendur, por jo si një budalla.

– Mirëbesimi e ushqen bisedën më shumë se intelijenca. /Ekonomia Online/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ademi viziton FC Suharekën në Turqi, komplimenton organizimin e këtij klubi

ANTALYA, 19 JANAR (ER) - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, është duke qëndruar për vizitë në Turqi. Gjatë kësaj vizite ai është ka vizituar disa klube të cilat janë duke u përgatitur në Turqi për fillimin e kampionatit në futboll. Në mesin e klubeve që Ademi ka vizituar në Turqi është edhe FC Suhareka, e cila garon në Ligën e Parë. Me këtë rast, FC Suhareka ka falënderuar Ademin për vizitën dhe

mbështetjen që ka marrë nga ai. “Në ambientet e hotelit ‘Aska Lara Resort’ në Antalya të Turqisë kishim për vizitë kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, z. Agim Ademi. Ndihej jashtëzakonisht të nderuar nga vizita e tij dhe kënaqësi e madhe që gjeti kohë të na vizitojë në Turqi. Nga kryetari Ademi morëm fjalë të mira dhe komplimente sa i përket organizimit të klubit duke na uruar suksese për arritjen e

objektivave. Drejtori sportiv i klubit tonë, z. Lulzim Kolgeci, shprehi falënderimet ndaj kryetarit për vizitën dhe gatishmërinë e Federatës ndaj klubeve dhe kontributin e madh në zhvillimin e futbollit të Kosovës”, ka njoftuar FC Suhareka. Po gjatë qëndrimit në Turqi, Ademi është takuar edhe me dy futbollistët e Kombëtares së Kosovës, Bernard Berishën, i cili luan për FC Akhmat Grozny dhe Valon Berishën e FC Lask.



Mentorët e UEFA-s të kënaqur me zhvillimin dhe masivizimin e futbollit në Kosovë

PRISHTINË, 19 JANAR (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) është vizituar nga dy mentorët e shquar të UEFA-s, Stuart Grieve dhe Vladimir Luptak. Ata kanë qëndruar në Kosovë për ta vlerësuar dhe ndihmuar zhvillimin e departamentit “Grassroots” në kuadër të FFK-së. Ky departament ka një rol kyç në rritjen dhe zhvillimin e futbollit në vend, me synim masivizimin dhe ofrimin e mundësisë për të gjithë të rinjtë që të përfshihen në lojën e futbollit në të gjitha kategoritë. Në “workshop”-in e organizuar me departamentet e tjera që janë të ndërlidhura apo ndihmojnë në projektet e departamentit

“Grassroots”, mentorët e UEFA-s kanë bërë një vlerësim të hollësishëm të gjendjes dhe aktiviteteve të këtij programi. Ata janë shprehur mjaft të kënaqur me përparimi ne shpejtë të FFK-së që nga pranimit në UEFA dhe FIFA, duke vlerësuar përkushtimin për masivizimin e futbollit përmes “Grassroots”. Në kuadër të vizitës së tyre, Stuart Grieve dhe Vladimir Luptak, përveç takimeve në FFK, kanë vizituar edhe “KF Rilindja” në kryeqytet. “Ata morën informacione mbi funksionimin e klubit, sfidat me të cilat ballafaqohet dhe sukseset e arritura. Gjithashtu, ata panë nga afër edhe zhvillimin e ‘Kinder



Ligës’ në Suharekë, një aktivitet ky i dedikuar për fëmijët deri në moshën 10 vjeç. Ata vlerësuan përkushtimin e lartë të fëmijëve

ndaj lojës së futbollit dhe për mënyrën se si ‘Grassroots’ ndihmon në rritjen e tyre. Po ashtu, lavdëruan edhe gjyqtarët e

angazhuar në këtë aktivitet, të cilët, përkundër moshës së re, shfaqën vetëbesim dhe qëndrim në ndarjen e drejtësisë. Në përfundim të vizitës, dy mentorët e UEFA-s dhanë vlerësime, këshilla, ide dhe informacione në takimin e përbashkët me ushtruesin e detyrës së sekretarit të përgjithshëm, Markus Weidner dhe menaxheren e ‘Grassroots’, Albina Rrahmani. Ata siguruan se do të vazhdojnë të japin mbështetje të fortë në zhvillim të futbollit në Kosovë, teksa vizita e tyre dëshmon përkushtimin e UEFA-s në projektet ‘Grassroots’ dhe përparimin e mëtejshëm të futbollit në vendin tonë”, ka njoftuar FFK-ja.

Fundjavë e ‘zjarhtë’ në basketbollin vendor



Prishtinë, 19 janar (ER) - Në fundjavë zhvillohet Java 18 e “Prince Caffè Superligës”, që gjithnjë e më shumë po bëhet interesante. Takimi i parë dhe derbi i kësaj xhiroje zhvillohet sot (e shtunë) në mes të Golden Eagle Yllit dhe Pejës. Ish-kampionët dhe kampionët do të përballen në një sfidë që pritet të jetë shumë interesante. Therandasit janë në vendin e katërt me dhjetë fitore e shtatë humbje, ndërsa pejanët në vendin e dytë me 12 fitore me pesë humbje. Ndeshje shumë e vlefshme është edhe ajo ndërmjet skuadrave prizrenase, Bashkimit dhe Proton

Cable Prizrenit, që synojnë të paktën “play-off”-in në këtë edicion. Bashkimi është në vendin e gjashtë me gjashtë fitore e 11 humbje, kurse Prizreni në vendin e shtatë me pesë fitore dhe 12 humbje, andaj ky takim është shumë i rëndësishëm për të dyja skuadrat. Ndërsa nesër (e diel) Istogu do të ndeshet me Sigal Prishtinën. Istogasi janë në vendin e fundit me një fitore e 16 humbje, kurse prishtinasit në vendin e tretë me 11 fitore e gjashtë humbje. Ndeshja e fundit për këtë xhiro është ndërmjet Trepçës dhe Vëllaznimit. Mitrovicasit janë

liderë me 15 fitore e dy humbje, derisa kuqezinjtë renditen të pestit me tetë fitore dhe nëntë humbje.

“PRINCE CAFFE SUPERLIGA” - JAVA 18:

Sot (e shtunë)

17:00 Golden Eagle Ylli – Peja
19:00 Bashkimi – Proton Cable Prizreni

Nesër (e diel)

17:00 Istogu – Sigal Prishtina
19:00 Trepça – Vëllaznimi

Mourinho, afër marrëveshjes me Al-Shababin

Riad, 19 janar - Jose Mourinho është bërë me dije se ka rënë dakord të bëhet menaxher i ri i skuadrës së Arabisë Saudite, Al-Shabab. “Special One” është shkarkuar nga Roma në fillim të kësaj jave

pas një ecurie të zymtë në Serinë A. Por, është thënë se ai ka vendosur për një rikthim të menjëhershëm në lojën e bukur pas bisedimeve pozitive me krerët e Al-Shababit. Sipas mediumit saudit “Aawsat”,

Mourinho ka mbajtur një takim me “Zoom” me drejtorin sportiv Dominico Tite përpara se të pranonte verbalisht të bëhej menaxheri i tyre i ri. Ekipi i rekrutimit të Superligës së Arabisë Saudite tashmë i kishte

dhënë Al-Shabab lejen për të diskutuar një kontratë marramendëse monetare. Dhe Mourinho supozohet se do të fluturojë për në Riad në ditët në vijim për t’i finalizuar kushtet e marrëveshjes së tij të re.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nikoll Radi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Agron Syla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Arbër Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10, 11, 12 dhe diplomën e sh.m. "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë.

- Alfred Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, 12 të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Ulvije Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m. "Mustafa Bakija" nga kl. I-IX.

- Rasim Kokalla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e A.P. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Diori" SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Selim Kastrati, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810098716 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Diori" D.O.O. Gnjlane, sa vllasnikom Selim Kastrati, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810098716 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Diori" L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Selim Kastrati, has come to the decision to quit its business: 810098716 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





TRADITË QË NGA 1992

